

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"AVLONA 02" SHPK

NENI 1

Themelohet me date 04/09/2023 shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "AVLONA 02" sh.p.k., mbeshtetur ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar, ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjin nr. 9121, date 28.7.2003, "Per Mbrojtjen e Konkurrences", Kodin Civil dhe Kodin e Punes me ortak themelues si vijon:

Denis Hysa, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18/05/1995 lindur në Borizanë dhe banues në Burizane, person madhor, me zotesi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar, me Nr. Personal J50518016N;

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Fushë-Krujë, Borizane Fshat Borizane, rruga Kadius, Ndertese private, 1 kateshe, Zona Kadastrale nr. 1247. me Numer Pasurie 1
2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranes.
3. Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjetër.



KOHEZGJATJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE

NENI 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

1. Import eksport me shumice e pakice te artikujve industriale, ushqimore, konfeksione. Tregetim dhe prodhim te materialeve te ndertimit, inerte, servis, lavazh, riveshje gomash, tregetim import eksport gomash te perdorura, transport mallrash e pasagjeresh brenda dhe jashte vendit. Tregeti me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 5

1. Kapitali i shoqërisë ka vlerën 100 lekë i cili përbëhet nga 1 kuotë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi te kapitalit nëpërmjet shtimit te kuotave te reja, ortakët kanë te drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund te zvogelohet nen kufirin minimal qe lejon ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

KONTRIBUTET

NENI 6



Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, **Denis Hysa** si vijon:
Ortaku **Denis Hysa** zotëron 100 % të të gjithë vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlere prej 100 lekë;
Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakut të vetëm si më sipër.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 7

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqesimi i nje ortaku nga nje ortak tjetër apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkrese, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nese në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që



kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare":

8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
 - c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës);
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës);
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;



d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave dhe vendimet merren me shumicë të gjysmën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo çështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 70% e kuotave janë të pranishëm, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këto raste vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

ADMINISTRIMI

NENI 8

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm për mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në cdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.



4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

NENI 9

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblesën e përgjithshme përsa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.



EMERIMI I PARE I ADMINISTRATOREVE

NENI 10

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet ortak **Denis Hysa**

E DREJTA E VOTES

NENI 11

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

E DREJTA PER TE KALUAR REZOLUTE

NENI 12

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolute në mbledhjen e asamblese se përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

ZHVILLIMI I SHOQERISE

NENI 13

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin e saj, seline ligjore, objektin, mund të zmadhojë apo të zvogelojë kapitalin themeltar, mund të pranojë ose të largojë ortakë.

MARRREDHENIET E PUNES NE SHOQERI

NENI 14

Shoqëria do të përpilojë dokumentet përkatëse për punësimin e personave të tretë duke respektuar dispozitat e Kodit të Punës.

VULA E SHOQERISE

NENI 15

Shoqëria ka vulën e saj në mënyrë të zakonshme me tekstin përreth saj.

FITIMI I PERSONALITETIT JURIDIK



NENI 16

Shoqeria do te rregulloje veprimtarine e saj edhe me Statutin e saj, i cili pasi te nenshkruhet nga ortakët themelues do te fitoje personalitet juridik ne ditën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

BILANCI DHE FITIMI

NENI 17

- 18.1. Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të çdo viti.
- 18.2. Llogaritë vjetore, inventari raportet mbi operacionet e viti financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël, miratohen nga asambleja e përgjithshme e shoqërisë.
- 18.3. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

FUNKSIONIMI I SHOQERISE

NENI 18

Rregullat per funksionimin dhe drejtimin e shoqerise pervec ketij Akti Themelimi jane te percaktuara ne Statutin e Shoqerise.

ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 19

Te gjitha mosmarreveshjet me organet shteterore, personat juridike e fizike vendas e te huaj, do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas legjislacionit ne fuqi.

DISPOZITA TE TJERA

NENI 20

Ky akt themelimi perpilohet në katër kopje, duke patur secila kopje fuqi te plote ligjore.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortakët themelues të Shoqërisë "AVLONA 02" sh.p.k.

THEMELUESI I SHOQËRISË

Denis Hysa

Denis Hysa
